

Procesverbal

Nga seanca e II-të (dytë) e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 30.01.2018, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

R e n d d i t e

1. Dhënia e betimit të 3 delegatëve të KK-së Dragash: z.Velid Haxhisin e z.Munir Jonuzi (nga kolaicioni "Vakat") dhe z.Florent Rufati (nga AAK-ja),
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit, nga seanca e kaluar e Kuvendit...,
3. Propozimi dhe zgjedhja e e 2 komiteteve obligative të Kuvendit Komunal...:
 - a) Komitetit për Politikë e Financa..., dhe
 - b) Komitetit për Komunitete..., të paraparë sipas UA Nr.03/2014 (të dërguar me materialin e sencës së I-rë tëKK-së),
4. Propozimi dhe zgjedhja e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës...,
5. Propozimi dhe zgjedhja e e Komisionit për Ankersa lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës..., dhe
6. Eventuale...

Seancën, me përshëndetje të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu, me kërkesën e deklaramit të delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...? Nëse jo, miratohet, njëzëri, rendi i ditës.

Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Fillimisht, kemi betimn e 3 delegatëve të ri të KK-së dhe atë z.Velid Haxhisin e z.Munir Jonuzi (nga kolaicioni "Vakat") dhe z.Florent Rufati nga AAK-ja, që i ftoj, me radhë, të bëjnë Betimin, duke lexuar tekstin e tij...

Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Kryesuesi- I falënderojmë dhe u dëshirojmë punë të mbarë delegatëve të rinjë, kurse në vazhdim kemi pikën e II-të e që do t'a kemi zakonisht të parën lidhur me miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar e Kuvendit, nëse ka vërejtje apo plotësime...?

z.Laurat Krasniqi- Në media kam lexuar se Nënkryetari i Komunës, për komunitete, qenka zgjedhur në mënyrë të jashtligjshme, që kërkon informa e sqarime lidhur me këtë?

Kryesuesi- Meqenëse kjo çështje nuk ka të bëj me Procesverbalin, konsideroj që t'a kemi parasysh në pikën e fundit - "eventuale" dhe kush është për miratimin e Procesverbalit...? Nëse nuk kemi vërejtje, njëzëri, e miratojmë Procesverbalin.

Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Në kuadër të kësaj pike tani e kemi propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve për 2 komitetet obligative: Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, sipas UA nr.03/2014. Duke e pasur parasysh këtë dokument politko-juridik, këto komitete nuk mund të kanë më shumë se 7 anëtarë dhe atë duke u bazuar në përbërjen-përfaqësimin me numrin e delegatëve të subjekteve politike në Kuvend, si dhe duke ardhur në shprehje barazia gjinore. Sipas kësaj, “çelsi” i përfaqësimit do të duhet të jetë 5 përfaqësues nga komuniteti shumicë e 2 nga ai jo shumicë, përkatësisht 3 nga PDK-ja (përfshi edhe Kryesuesin e Kuvendit – që parashihet sipas funksionit), 2 nga LDK-ja dhe 2 nga komuniteti jo shumicë: 1 nga Vakati dhe 1 nga JGP-ja dhe, pa humbur kohë, kalojmë në propozimin e kandidatëve, fillimisht, për KPFinanca...?

z.Nexhat Isufi- Kjo seancë është e dyta, përkatësisht e para në të cilën fillojmë aktivitetin në bazë të të cilit u jemi paraqitur qytetarëve gjatë fushatës zgjedhore, për të qenë transparent e për të punuar për popullin. Këto propozime që i paraqiti Kryesuesi për ndarje - 3 andej e 2 këndeje (PDK-LDK), unë me këtë nuk pajtohem, pasi se të dy këto komitete janë për popullin, duke filluar nga KPFinanca i cili është më i rëndësishmi e aty, si të thuash, po ndahen “delet e dhitë” dhe, për të qenë demokrat e transparent, edhe ne, nga subjektet tjera, duhet të jemi të përfaqësuar, që, pra, unë mendoj se duhet të janë të përfaqësuar sa më shumë subjekte politike, për t’u dhënë kontributi maksimal. Pra, “Nisma për Kosovën” dëshiron që të ketë përfaqësuesine vetë në KPFinanca?

z.Laurat Krasniqi- Subjekti politikë-LVetëvendosje, për herë të parë, është e përfaqësuar në Kuvend dhe, sipas radhitjes, jemi partia e 3-të më e madhe nga komuniteti shumicë dhe përfaqësojmë 720 vota. Në vlerën absolute, jemi të përfaqësuar me një delegat apo 5,25% të votuesëve. Dhe, si rezultat i kësaj, edhe ne dëshirojmë të kemi përfaqësuesin tonë në KPFinanca dhe nuk ka arsye të bëhen përjashtime, pasi se ngjajshëm ka ngjarë në Drenicë dhe se MAPL-ja e këthyer Vendimin e tillë?

z.Hajrudin Hoxha- KPFinanca do të ketë 2 përfaqësues nga komuniteti jo shumicë, por unë jam i vetmi polikan i cili është në opozitë dhe dëshiroj që opozita të dinë se çka po ngjan në KPFinanca dhe, JGP e Vakati, të merren vesh dhe të japin një delegat e ne si PG-ne dëshirojmë të përfaqësohemi në këtë Komitet? Nëse nuk pranohemi, do të thotë se koalicioni udhëheqës po i vendos njerëzit e vetë e të tjerit po duhet të presin?!

z.Velid Haxhisin- Pasi se për themelimin e këtij Komiteti ekzistojnë faktorë kufizues, siç është UA të cilin e kemi pasur si material e që cakton numrin e përfaqësuesëve të Kuvendit e ai është maksimalisht 7-të anëtar, unë do të ndërlihem në diçka që nuk e kemi bërë e është dashur e ky është neni 16.3 i UA ku theksohet se aktet nënligjore të komunës duhet të harmonizohen me me dispozitat e këtij Udhëzimi, jo më vonë se në fund të vitit 2014, e ne ende nuk e kemi harmonizuar Sstatutin e Komunës sonë me këtë UA e ku thuhet se në KPFinanca mund të janë 5-9 anëtarë? Ne nuk e kemi miratuar Vendimin e tillë e që mund të ngjan që, në ndonjerën nga seancat tona, Statuti të

harmonizohet. Ne, si koalicioni Vakati, me 3 anëtarë-delegatë të Kuvendit në mandatin e kaluar nuk kemi pasur asnjë anëtar në KPFinanca dhe dëshiroj të ju them se Ligji parashef përfaqësimin në KPFinanca e që duhet të përfaqësohet sipas anëtarëve në Kuvend dhe nuk mundet që PDK-ja e cila ka 9 anëtarë të ketë një anëtar në KPFinanca e mos të flitet për ata që kanë nga një anëtar në Kuvend dhe për këtë nuk duhet të ketë mospajtime. Pa dyshim se nga ky Kuvend dikush do të dalë i pakënaqur, që është normale, por që mendoj se propozimin të cilin e ka dhënë Kryesuesi është zgjidhje e vërtetë për themelimin e KPFinanca.

z.Zaim Hajredini- Edhe unë lidhur me këtë e kam vërejtjen e mosëharmonizimit të Statutit me UA dhe dëshiroj të jemi të kujdesshëm e mos të bëjmë gabim e që kjo çështje të na përsëritet për seancat tjera. Sa i përket Komuniteteve nuk është e definuar 7 anëtarë, që do të thotë se mund të kemi - deri në 9 anëtarë. Unë kam dëshiruar që të jetë përfshirja sa më e gjërë, pasi se e dijëm se në komitete bëhen parapërgatjet për seancat e Kuvendit. Në këtë përbërje, si duket, kemi përfshirje vetëm të subjekteve të mëdha politike, kurse ato të vogëla nuk janë përfshirë. Nëse mendoni se ashtu do të funksionohet më mirë, në rregull? Dua të shprehësh se, më vonë, nuk do të kemi probleme më të mëdha në këtë proces?

Kryesuesi- Në bazë të UA është vepruar dhe kemi propozimin prej 7 anëtarëve, që e vejmë në votim dhe kush është "për"-14. Pra, kalojmë në propozimet konkrete.

z.Granit Rifaj- Në emër të PDK-së, propozoj z.Xhemile Misinaj dhe z.Artan Loshaj në KPFinanca, kurse në Komunitete z.Vehbi Nazifi dhe z.Elira Sulejmani-Krasniqi.

z.Samidin Xheladini- Nga LDK-ja në KPFinanca propozojmë z.Aida Misini-Halimi dhe z.Arjeta Skeraj.

z.Munir Jonuzi- Ne, nga koalicioni Vakati, propozojmë z.Zinaida Elmazi.

z.Selman Osmani- Meqenëse ne nga JGP-ja jemi herën e parë të përfaqësuar në Kuvend e unë jam Selman Osmani, tani edhe zv.kryesues i Kuvendit, në KPFinanca propozoj vetëvehten-Selman Osmani.

z.Nexhat Isufi- Shprehësh se këta anëtarë do të zgjedhen në KPFinanca. Por, po na del interesante se PSDK-ja e LDK-ja, si dy parti më të mëdha, paskan bërë marrveshje?!

Kryesuesi- Kalojmë në votim për anëtarë të KPFinanca dhe kush është "për"-18 "kundër"-0 dhe "abstenim"-0 vota.

z.Laurat Krasniqi- Mendimi im personal dhe i LVetëvendosje është se shumica e qytetarëve nuk përfshihen në komitete, më shumë se 1500 votues?! Ne jemi votues të vitimit më 22.10.2017, por shumica e qytetarëve nuk është e përfshirë? Partitë më të mëdha maksimalisht po tentojnë të na injorojnë neve si opzitë dhe përfaqësues të partive më të vogëla e kjo mos do të jetë jashtëligjore?

z.Velid Haxhisin- Më vjen keqë që prap po lajmërohem, ndoshta po e thej Rregulloren e Punës së Kuvendit, dhe kjo të evidentohet si replikë, pasi se edhe ne, më 2013, jemi anashkaluar me 1500 votues dhe aty ka qenë edhe GIG-u i cili nuk ka pasur përfaqësuar në KPFinanca dhe, pra, nga ky Kuvend, nuk mund të dalin të kënaqur të gjithë, pasi se përbërja e Kuvendit nuk është e atillë që të bëhet diçka e tillë, siç e kërkojnë kolegët. Për mua do të ishte e kënaqshme që të përfaqësohen të gjithë, por, momentalisht, kjo nuk është e mundur.

Kryesuesi- Kalojmë në propozimin për KKomunitete i cili duhet të jetë me shumicë nga komuniteti jo shumicë e që do të ketë 7 anëtarë dhe atë 4 nga komuniteti jo shumicë e 3 nga komuniteti shumicë, përfshirë këtu edhe përfaqësimin adekuat gjinor dhe a kemi propozime?

z.Granit Rifaj- Në emër të PDK-së në këtë Komitet propozojmë z.Vehbi Nazifi dhe z.Elira Sulekmani-Kryasniqi.

z.Samidin Xheladini- Në emër të LDK-së propozojmë z.Refik Latifi dhe z.Adelisa Krasniqi.

Kryesuesi- Ju kisha lutur, që ju nga LDK-ja, të propozoni vetëm një kandidat, pasi se u përcaktuam për “çelsin” prej 7 anëtarëve.

z.Zinaida Elmazi- Nga koalicioni Vakati propozojmë z.Velid Haxhisin dhe z.Munir Jenuzi, kurse nga GIG-u z.Rexhap Kamberi.

z.Selman Osmani- Nga JGP-ja propozoj z.Hatixha Sheh.

Kryesuesi- Pra, nga LDK-ja duhet të propozohet vetëm një kandidat, pra të shkojmë në votim për 7 apo 9 anëtarë?

z.Granit Rifaj- Sa për të sqaruar, ne votuam për 7 anëtarë dhe nuk mund të jetë 8 apo 9-të dhe u votua për këtë dhe, njëri nga të propozuarit e LDK-së, duhet të tërhiqet?

z.Nexhat Isufi- Në kuadër të procedurave në rend dite ishte themelimi i komiteteve me numrin e anëtarëve të tyre dhe numrin e anëtarëve është dashur rregulluar me Rregulloren dhe Statut, si dhe Ligjin e ne nuk guxojmë të veprojmë siç na tejkjet? Duhet të veprojmë sipas Ligjit dhe, nëse UA nuk lejon më shumë se 7 anëtarë, ne duhet të ndryshojmë Statutin e të vazhdohet me procedura. Kështu, dihet se kjo i konvenon PDK-së e LDK-së, por ku do të janë nesër rezultatet?! Pra, si do të dalim nesër para qytetarëve, pasi se ne jemi zëri i qytetarëve e organi më i lartë është KK-ja dhe nuk guxojmë të bëjmë gabime.

z.Zaim Hajredini- Askush nuk po del për të thënë që të shtohet numri i komiteteve nga 7 në 9 anëtarë dhe tani, pasi votuam, po biem në pozitë të papërshtatshme. Nuk po e fajësoj askend, por ne votuam për 7 anëtarë dhe tani duhet të pajtohemi me formulën të cilën nuk e di se nga ka ardhur, por, gjithësesi, nuk duhet të tejkalojmë numrin prej 7 anëtarëve, apo të shfuqizojmë votimin që e

kishim dhe të fillojmë nga e para?! Pra, në njëfar mënyre, duhet të gjendet zgjidhje, që mos të na del më vonë Vendimi i kundërligjshëm dhe të na kthehet nga MAPL-ja?!

z.Vehbi Nazifi- Mendoj se “çelësi” dhe procedurat janë në rregull, sepse përfaqësojnë partitë kryesore në Kuvend 9:7 dhe, në rastin e KPFinanca, nuk merret parasysh Kryesuesi i Kuvendit që është edhe Kryesuesi i këtij Komiteti. Ka mund të nganë edhe e kundërta, nëse do të ishte përfaqësimi në Kuvend ndryshe nga subjektet tjera. Mendoj se LDK-ja duhet të tërheq një kandidat e mos të bllokohet procesi, sepse s’di se sipas cilit kriter po dëshironi të barazoheni me partinë më të madhe e dihet se ne (PDK) kemi 9 e ju (LDK) 7 anëtarë në Kuvend dhe, më së miri do të ishte, të tërheqni njerin kandidat?

z.Hajrudin Hoxha- Po shifet se në mes të partive të shumicës-PDK-së e LDK-së e pastaj edhe nga Vaktai, JGP-ja e GIG-u, pasi se këto komitet paguhen, në pyetje qenkan paratë që pra edhe ne (PG-a) dëshirojmë të kemi një kandidat dhe e propozoj z.Sali Ibishko, pasi se këtu në pyetje janë vetëm paratë?! Theksoj se, kur të vjen fjala për komisione, nuk do të pranon askush, pasi se aty nuk parashihen pagesa?!

Kryesuesi- Qysh në fillim, u përcaktuar për numrin në 7 anëtarë të komiteteve dhe presim që LDK-ja të tërheq njerin kandidatë në këtë Komitet, apo të kthehemi në fillim?!

z.Vehbi Nazifi- Për “çelësin” ishim përcaktuar dhe nuk e di se si të vazhdohet, apo të votohet për secilin kandidatë – veq e veq?

Kryesuesi- Nëse pajtoheni, të bëjmë në pazë 5 minutëshe ?...(miratohet propozimi...)

Vazhdojmë me seancën, që pra nga PDK-a kemi 2 kandidatë e LDK-ja 1 kandidat.

z.Sefidin Mejzini- Sa i përket “çelësit” apo “formulës”, ju që e keni shumicën në Kuvend-PDK, jam i vetëdijshëm se e keni shumicën e votave dhe nuk keni kurrfar brenga, por, gjithësesi, duhet të jeni të kujdesshëm dhe ne tani do të shkojmë me 1 kandidat-z.Refik Latifi.

Kryesuesi- Vazhdojmë me votimin dhe kush është që anëtarët e përmendur të janë anëtar të Komunitete?

z.Hajrudin Hoxha- Athua do të thotë që, unë që jam në opozitë, nuk kam të drejtën as të propozoj e as të votoj dhe çka u bë me kandidatin që e propozova unë, që kërkoj nga Kryesuesi të më jepet përgjigje dhe të vëhet në votim, pavarësisht se do të mbivotohesha?!

z.Granit Rifaj- T’i jap një sqarim sqarim parafolësit se UA e përcakton qartë se anëtarë në komitete janë edhe ato komunitet që nuk janë të përfaqësuar në Kuvend, kurse komuniteti Goran është përfaqësuar në Kuvend.

z.Hajrudin Hoxha- E falënderoj kolegun Granit R. në sqarimin e dhënë, por unë kërkoja sqarim nga Kryesuesi. Ajo se a jemi të përfaqësuar apo jo, nuk është problem dhe, gjithëse, jemi të përfaqësuar, sepse nëse partitë e mëdha paskan përfaqësues në komitete, atëherë nuk paska nevojë që të jemi ne fare, vetëm për të ngritur dorën?! Pra, unë kërkoja sqarim nga Kryesuesi e jo nga ndonjëri delegat?!

z.Granit Rifaj- Sqarimin që e dhash ishte në emrin tim personal. “Çelësi” apo “formula” që u paraqit ishte sipas UA e që janë përfshi komitetet në Kuvend e mos të propozohen edhe tjerë dhe, nëse ndonjë nga komuniteti i përfaqësuar në Kuvend, nuk është përfaqësuar, atëherë mund të propozohen edhe të tjerë-jasht Kuvendit. Këtë desha t’i sqaroj kolegut Hajrudin H. dhe i kërkoj falje nëse qenka ofenduar?!

Kryesuesi- Vazhdojmë me votimin dhe kush është për anëtarët e përmendur...për Komunitete? 19-“për”, “kundër”-2 dhe “0-“të përmbajtur”, që pra themeluan edhe këtë Komitet.

Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Në këtë pikë kemi Propozimin për zgjedhjen e Komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës, që 3 janë nga ekzekutivi i Komunës:z.Ramadan Krasniqi, z.Islam Rexhepllarui dhe z.Xhevat Isufi, hapim diskutimet...

z.Shaban Shabani (kryetar)- Shfrytëzoj rastin t’u dëshiroj punë të mbar, duke e pasur prasysh se kjo është seanca e parë e punës në këtë mandat. Presim që të bëhen ndryshime në këtë Ligj të pronësisë, por, për deri sa mos të bëhen ato, ne duhet t’a kemi të themeluar Komisionin e tillë dhe nga ekzekutivi i komunës kam propozuar 3 anëtarët e paraparë, që i paraqiti kryesuesi.

z.Velid Haxhisin- Për të mos ardhur në situatë që të vendosim sërish për këtë Komision, neni 6.3 i UA thekson se “anëtarët e KPFinanca nuk kanë të drejtë të janë anëtarë e komisioneve tjera” dhe unë nuk kam asgjë kundër anëtarëve, por mos të vijmë në situatë që të na këthehen vendimet nga MAPL-ja e që duhet të evitojmë mospajtimet e tilla, kurse, njëherësh, në këtë Komision po e propozoj z.Munir Jonuzë, në emër të koalicionit Vakati.

z.Zaim Hajredini- Nga shoqëria civile mendoj se duhet të jet z.Jeton Qengaj i cili është aktiv përmes OJQ-së “Avoko”?

z.Shpetim Hajredini- Për këtë Komision, nga PDK-ja, propozoj z.Granit Rifaj ?

z.Arjeta Skeraj- Nga LDK-ja propozoj z.Sefidin Mejzini ?

z.Selman Osmani- Nga JGP-ja propozoj z.Hatixha Sheh?

z.Rexhep Kamberi- Nga GIG-u propozoj delegatin shumvjeçar z.Deir Jelmazi, por pasi se nuk ekziston e drejta e propozimit jasht Kuvendit, propozoj vehten-Rexhep Kamberi?

Kryesuesi- Një sqarim i shkurtër e që duhet pasur parasysh se Komisioni duhet të ketë 7 anëtar e që ne i propozuam dhe ata ishin: 3 nga ekzekutivi..., pastaj z.Munir Jonuzi, z.Jeton Qengaj, z.Sefin Mejzini dhe z.Rexhep Kamberi. Prandaj, kalojmë në votim dhe kush është për këtë Listë...”për”-19, “kundër”-0 dhe “të përmbajtur”-0 vota, që konstatoj se zgjedhëm Komisionin i cili në takimin e vetë të parë zgjedh edhe Kryesuesin e vetë?

Pika e V-të (pestë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Në kuadër të kësaj pike tani kemi Propozimin për zgjedhjen e Komisionit për Ankesa lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës, që është e dëshirueshme të janë anëtarë - profesionist? Mund të deklarohemi që Komisioni të ketë 5 anëtarë, udrëroni...?

z.Shpetim Hajredini-Nga PDK-ja propozoj z.Suada Bajrami ?

z.Arjeta Skeraj- Nga LDK-ja propozoj z.Naser Myrtezani?

z.Munir Jonuzi- Nga koalicioni Vakati propozoj z.Velid Haxhisin?

z.Zinaida Elmazi- Nga GIG-u propozoj z.Rexhep Kamberi dhe, pasi se nuk mundet z.Rexhep K. , propozoj z.Hajrudin Hoxha?

z.Hajrudin Hoxha- E falënderoj kolegën parafolëse në propozimin e bërë, por unë nuk e pranoj, pasi se ky Komision nuk paguhet, e unë këtu po jam delegat për para e jo për popull?!

z.Zaim Hajredini- Pasi se fjala është për angazhim pa pagesë e në shërbim të popullit, propozoj z.Florent Rufati.

z.Velid Haxhisin- Mua do të më vinte mirë të kishim më shumë kandidatë nga komuniteti jo shumicë, por, mjerisht, i shterrëm të gjitha mundësitë, që, edhe një herë, e kisha lutur z.Hajrudin H. të pranonte përgjegjësinë, sepse, në të kundërtën, kjo mund t'i takonte komunitetit shumicë?

z.Granit Rifaj- Këtë vend mund t'a pranonte z.Samidin Xheladini, pasi se dëshiron të punonte për popullin?

z.Samidin Xheladini- Unë këtë pozitë do t'u kisha lënë të rinjëve, por unë jam i revoltuar pasi se kishim një marrvëshje e ajo nuk u plotësua dhe për këtë nuk dua t'i përkas asnjë komisioni e do t'u jap përkrahje të tjerëve.

z.Vehbi Nazifi- S'di pse po ngurohet të hyhet në këtë Komisioni i cila, ndoshta, është më i rëndësishmi, pas KPFinanca, e këtu do të vijne nëpyetje ankesat e qytetarëve, nëse veq po i përmendim qytetarët, apo pengesë është mospagesa?! Këtu do të ketë punë edhe me ankesa për tenderë dhe është me rëndësi pjesëmarrja në ato. Për këtë, edhe një herë, do të kisha lutur z.Hajrudin H. që të pranonte këtë detyrë e obligim?

z.Rexhep Kamberi- Edhe unë, edhe një herë, apeloj në z.Hajrudin H. që të pranon këtë përgjegjësi, pasi se çështja është serioze dhe, po të mos isha unë anëtar i Komisionit paraprak, do t'a kisha pranuar këtë detyrë. Siç tha edhe parafolësi, ky Komision është i rëndësishëm e ne ne dijmë nga komuniteti joshumicë që i kemi pasur dofar probleme lidhur me këtë dhe, përfaqësuesi i komunitetit joshumicë këtu është tejet i rëndësishëm, dhe, nga kjo arsye e lus z.Hajrudin H. që të mendon dhe pranon këtë obligim?

z.Hajrudin Hoxha- Po më duhet të lajmërohem shpesh dhe ju falënderoj për këtë besim. Kur është në pyetje pagesa, po shtyhem se kush do të depërton dhe zotëriu të del nga KPFinanca e të pranon këtë e unë do të kaloj në vendin e tij?! Por, këtu nuk është fjala për këtë dhe nuk e pranoj nga arsyeja se nuk jam konsultuar fare kur është bërë fjalë për komitetet, si dhe ky Komision nuk paguhet e ne këtu jemi për para?! Përfaqësimi i popullit është vetëm mashtrim e kjo është parë gjatë mandatit të kaluar ku isha në këtë Komision e nuk jemi takuar fare dhe as që e kemi njoftuar Kuvendin për punën tonë dhe për këtë nuk dua të jem, vetëm në letër, anëtar i komisioneve.

z.Nexhat Isufi- Mbi 24 mijë qytetarë presin seancën tonë të sotme dhe, siç thekson populli, ne po flasim "pa lidhje" dhe KK-ja nuk është lojë, por vendi më serioz e po propozohet 3-4 herë i njejt person, e ai nuk po dëshiron ,e ju po dëshironi t'a detyroni me dhunë?! Edhe unë jam delegat, pse mua nuk po më propozoni dhe athu po nguroni nga Nexhat I. apo "X" "Y"?! Edhe ai që ka 3 mijë vota edhe ai që ka 100 vota t'a dini se është përfaqësues i popullit dhe mos mendoni se ndonjë parti është më e fortë se ndonjë tjetër?! Ju lutem, ata që dalin para foltores, të janë serioz. Pra, unë e propozoj z.Nexhat I. për anëtar të Komisionit, sepse ne jemi përfaqësues të popullim dhe me këtë duhet të mburremi e kjo vlen sidomos për ne delegatët më të vjetër, pasi se dikush po na monitoron!

z.Rexhep Kamberi- Për t'u ndërklidhur me parafolësin, Kuvendin duhet t'a kuptojmë seriozisht dhe për këtë Komision unë këtu pom dal për herë të tretë. Unë dola të propozoj kandidatin pasi se, ne nga komuniteti jo shumicë, bartim përgjegjësi e këtë ia kemi premtuar elektoratit gjatë fushatës zgjedhore. Për këtë, mendoj se duhet të jemi të përfaqësuar në çdo komision, pavarësisht se a paguhen apo jo ato. Të jem i sinqerë, unë deri para pak ditëve nuk e kam dijtur pagesën dhe mospagesën e tyre dhe kam pas në mendje kandidat tjetër? Tani, rastësisht, unë jam pjesë e shumicës parlamentare dhe jam propozuar në këtë vend, që pra qëllimi i diskutimit tim është që mos të bëjmë dallime në mes pagesës dhe mospagesës në komisione, por përmes pjesëmarrjes në komisione të japim kontributin tonë për efikasitet të Kuvendit.

Kryesuesi- Pra, kalojmënë votim dhe këtu janë propozuar kandidatët nga PDK-ja Suada Bajrami, nga LDK-ja Naser Myrtezani, nga Vakati Velid haxhisin, nga AAK-ja Florent Rufati dhe Nisma-Nexhat Isufi dhe kush është për këtë përbërje të Komisionit...? "për"-19, "kundër"-0 dhe "të përmbajtur"-0 vota, që kosntatoj se e zgjedhëm këtë Komision i cili, në takimin e vetë të parë, e zgjedh edhe Kryesuesin e vetë.

Pika e VI-të (gjashtë) e rendit të ditës -“eventuale”...

Kryesuesi- Vazhdojmë me punën dhe lidhur me këtë pikë - “eventuale” po theksoj se do të jetë pikë e rregullt dhe e zakonshme e seancave tona dhe në kuadër të saj do të parashtrijem pyetje, propozime e çështje tjera me interes për Komunën tonë, hapi diskutimin...

z.Laurat Krasniqi- Një pyetje për Kryetarin e Komunës e ajo është se një OJQ i ka organizuar garat e mundjes, që janë aktiviteti më i madh sportiv që realizohet në komunën tonë. Në bazë të evidencës, të cilën posedoj, në Listën e kësaj OJQ-je “Natyra” qëndron edhe nënshkrimi i Kryetarit dhe lind dyshimi se mos është keqpërdorur ai, apo? Pra, parashtrijem pyetja se a i ka marr Kryetari 30,00 euro nga kjo OJQ, apo jo? Në këtë duhet t’ia themi popullit, pasi se jemi përfaqësues të tij e, nëse është e kundërta dhe nuk i keni marr ato para dhe është keqpërdorur nënshkrimi juaj, e ju e përfaqësoni popullin, atë OJQ apo personat kompetent duhet t’ia paraqitni në Prokurori?! E dyta, më 2016 janë ndarë 80 mijë euro për ndërtimin e stadiumit, e kjo shifet nga Raporti i Auditimit, dëshiroj të njoftohem nga Kryetari se çka u bë me këtë projekt dhe kërkoj qasje zyrtare në këtë dokument dhe, se a duhet kërkesë, me shkrim apo me gojë?

z.Zinaida Elmazi- Në mandatin e kaluar nga ana e kryetarit të Komunës jemi njoftuar për blerjen e një kamere një OJQ-je dhe ajo kamerë shfrytëzohet për gjirime për komunitetin joshmicë “Svetlost Gore”. Por, sot pos mediave “Radio-Sharri” dhe “Radio-Bambus”, nuk po shoh media tjera dhe dëshiroj nga kryetari ose kryesuesi që të bëhet ndikim në atë televizion, që të janë prezent në takimet tona të Kuvendit që qytetarët të janë në dijeni me punën e Kuvendit dhe organet tjera komunale?

z.Nexhat Isufi-Kam një propozim që, në seancën e radhës, të kemi një pikë të rendit të ditës që të themelohet një Komision apo Panel për hartimin e Planit të Punës dhe komiteteve e këtë e kemi tentuar edhe në mandatin e kaluar e tani pra jemi në fillim të mandatit e të punohet në këtë drejtim?

z.Rexhep Kamberi- Kam propozim që për të ardhemen të angazhohet një zyrtar apo drejtori përkatëse për marrëdhëniet me diasporën e cila është tejet e interesuar për kontakte dhe punë me Komunën. Për këtë ne jemi të obligueshëm kur dihen se mjaft mjete na arrijnë nga diaspora në buxhetin komunal nga tatimi e shpenzimet tjera. Për këtë kërkoj nga kryetari e kryesuesi që kjo çështje të potencohet, në njerat nga seancat e Kuvendit?

z.Velid Haxhisin- Po theksoj me këtë rast se mbledhjet e komiteteve tona po zhvillohen nën kushte të vështirësuar e pa përkthim simultan e që prapoj të ndahen mjete për këtë çështje, pasi se mbledhjet po zgjasin më shumë se sa duhet, që ato paisje (diku 10 mikrofonë) të instalohen edhe në zyrën e nënkryetarit ku i mbajm takimet e tilla. Në këtë mënyrë do të kursehej koha e jo të zgjasin takimet 3-4 orë, për tu pritur përkthimi gojor? E dyta-qysh në fillim të mandatit, dëshiroj t’ia përciell kryetarit rrezikun në rrugën rajonale Dragash-Restelicë , sidomos për 3 fsjhatrat e komunitetit jo shumicë, nga rrëshqitja e gurëve, por që ka raste edhe në vende tjera, për të mos ardhur te situata të

padëshëruara. Këtë e bëj si apel për kryetarin, për të kontaktuar me institucionet kompetente për mirëmbajtjen e rrugëve dhe, bashkarisht me ato, të parashihen edhe mjetet e nevojshme që ky problem të zgjidhet. Me këtë duhet të merren edhe nënkryetarët dhe drejtorët e drejtorateve komunale?

z.Samidin Xheladini- Duke e pasur parasysh se është fillimi i mandatit, me rëndësi është që ekzekutivi të kenë për miratim Rregulloren për Transparencë, pasi, me sa e di unë, një Rregullore të tillë nuk e kemi e këtë e kemi obligim ligjor, siç e kanë edhe komunat tjera. Kjo është me rëndësi, për të mos u dyshuar në çështjet që kanë të bëjnë me transparencën e organeve komunale, si dhe për të qenë më transparent se gjatë mandateve të mëhershme?

z.Arjeta Skeraj- Pasi se është fillimi i mandatit, dëshiroj të pyes kryetarin se a i ka vizituar shkollat në nivel të Komunës, pasi se jemi në sezionin dimëror dhe a janë të furnizuara me lëndë djegëse?

z.Zaim Hajredini- Kam dy kërkesa e s'di se sa është e arsyeshme në aspektin ligjor se a është përfshirë mirëmbajtja e rrugës Zaplluxhe-Cylen-Prizren, pasi se ajo rrugë mjaft shfrytëzohet nga qytetarët e, njëfat mënyre, është e i bllokuar dhe nëse nuk është kompetente MInfrastrukturës, të shifen mundësit e intervenim nga Komuna në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve lokale? E dyta, dëghova se seancat tona nga sot e tutje do të përcillen edhe përmes You Tube, a ekziston mundësia që ato t'i kemi edhe në video në periudhën e ardhëshme, për t'u parë se çka punojmë dhe se kjo është në kuadër të transparencës?

Kryetari- Do të mundohem të përgjigjem në pyetjet të cilat jam munduar t'i përfshij nga diskutimet tuaja. Lidhur me zgjedhjen e nënkryetarit të Komunës për komunitete joshumicë, realisht, kontesti mund të jetë vetëm te përkatësia etnike e jo në aspektin e procedurës zgjedhore. Unë, lidhur me këtë, kam qenë në kontakte me MAPL-në dhe u kemi dërguar një shkresë, pas shkresës së tyre, dhe ka qenë i kyçur vetë nënkryetari për komunitet dhe ZKKKthimit dhe presim përgjigjen e MAPL-së? Nëse MAPL-ja qëndron prapa kërkesë së tyre, atëherë, bashkarisht, me kryesuesin, do të duhet t'a procedojm rastin në Kuvend, për rishqyrtim, pasi se MAPL-ja është organi i cili merret me ligjshmërinë e vendimeve tona? Lidhur me organizimin e aktiviteteve sportive që janë bërë përmes një OJQ-së, unë atë informatë e kam marr përmes rrjeteve sociale, ndoshta me vonesë, por ndoshta nuk është e rrugës të merrem komentet e plasura në faqet e rrjeteve sociale, si facebook etj., por pasi se bëhet fjalë për pyetje të delegatit, mund të them se unë nuk jam anëtar i asaj OJQ-je që ka organizuar garat dhe s'kam asgjë të përbashkët, dhe, nëse mendoni se ka diçka të kundërligjshme, ekzistojnë procedurat e rregullta ligjore që mund të inicohen? Ate që e di them është se secila organizatë duhet të vepron sipas ligjeve në fuqi. Sa i përket stadiumit të qytetit, keni të drejtën e qasjes në dokumente zyrtare dhe jo vetëm ju, por kushdo qoft nga qytetarët, duke plotësuar dokumentin përkatës e shërbimet janë të detyruara t'u ofrojnë ate. Për këtë unë personalisht ju përkrahi juve dhe të gjithë qytetarët që ndërmarrin iniciativa të tilla ku mendoj se diçka nuk ka qenë

në rregull. Ne jemi këtu për çështje të tilla, ne së bashku-si Kuvednin dhe kryetari. Unë jam tejet i vetëdijshëm për gjëra të tilla dhe mund të ngjanë që unë të gaboj e kjo nuk do të thotë që të kursehem dhe, për këtë qysh në fillim, kam thënë se unë jam i lidhur ngusht të bashkëpunoj me Kuvendin, sepse, tek e fundit, Kuvendi është në rolin e mbrojtësit të kryetarit dhe pushtetit ekzekutiv dhe, nëse gabojmë, mund të gabojmë, por jo qëllimisht për të keqpërdorur pushtetin dhe mjetet. Asnjë drejtor, apo punëtorë në këtë kuptim nuk do të ketë mbrojtjen time dhe këtë po them publikisht. Nëse dikush punon ndryshe, lirisht do të dërgohet në shtëpi dhe është koha e fundit që njerëzit të vetëdijesohen në çdo aspekt e ju jeni përfaqësues të popullit dhe unë e kërkoj bashkëpunimin tuaj dhe ju respektoj, duke e dijtur se jeni në organin më të lartë të Komunës-në Kuvend. Unë e kam obligim ligjor të njoftoj, 4 herë vit, Kuvendin dhe ju jeni mbikëqyrësit e mij. Kryesuesi i Kuvendit dhe ju delegatët keni të drejtën e qasjes kudo dhe kurdo herë në çështjet zyrtare dhe dyert e mia janë të hapura gjithmonë për ju për çfardo çytje e çështje të interesit publik, kurse për çështjet tjera po theksoj se nuk do të kursehet askush. Ndoshta, nuk është mirë që këtë po e theksoj, por duhet të dëshmojnë veprat e jo fjalët dhe askush nuk është mbrojtur dhe secili do të ketë përgjegjësitë e veta. Shumë njerëz po presin punë dhe gjithkush duhet të bënë punën e vetë e sidomos ne që këtu jemi për popullin. Me sa jam i njoftuar për atë TV kamerën ka qenë një donacion i përbashkët me RTK-në dhe Komunën, që të transmetohen emisione për komunitetin dhe se dij se a vlen ajo edhe për përcjelljen e seancave të Kuvendit tonë, sepse dihet se secili transmetim kushton, por do të interesohem për këtë punë? z.Nexhat I. e përmendi Planin e Punës së Kuvendit, do të ishte mirë të prozohen 2-3 veta pasi se duhet të punohet me Plan e që do t'a kemi gjithsesi. Çështja e caktimit të personit për lidhje me diasporën, kjo është vështirë të caktohet zyrtar, por do të shifen mundësit se çka mund të punohet në këtë drejtim, sepse mendoj se kontaktet e organeve të Komunës sonë me diasporën duhet të ekzistojnë e forcohen. Çështja e përkthimit, po theksoj se, vërtetë, na krijon probleme teknike, pasi se edhe vetë po e shihëno se mezi po ia dalim me këto paisje e kushte që kemi, kurse sigurimi i pasijeve të reja, jemi interesuar, se kushton shumë shtrenjtë e po mundohemi me riparime-sa mundemi. Në këtë drejtim, shpresoj se me rinovimin që parashohim të sallës, këtu do të përfshihen edhe paisjet e përkthimit emë vonë edhe përkthimin e takimeve të komiteteve tona. Ndërkaq, sa i përket rrezikut në rrugëne 3 fshatrave-për kah Restelica, unë kam kontaktuar personalisht me Ministrin e Minfrastruktues nga i cili kam marr garancione se do të ketë intervenime në këtë drejtim rrugor, pasi se, kohëve të fundit. kemi mjaft rrëshqitje të dheut që paraqesin rrezik për qytetarët. Kemi biseduar edhe reth asfaltimeve të reja, mirëmbajtjes dimërore të rrugëve rajonale dhe atyre të reja, si nga: Zaplluxhja për Prizren dhe Krusheva-Shishtavec(i)kufi) e që kemi premtime, nga të cilat presim, e për këtë kemi edhe kërkesën e Policisë sonë e mundësitë tona, si Komunë, për këto nevoja janë shumë të vogëla. Lidhur me Rregulloren për Transparencë, ne tash më e kemi ate dhe Planin, ndërsa lidhur me furnizimin e shkollave me lëndë djegëse ato janë furnizuar, por ka lind nevoja që disa të furnizohen me sasina shtesë e shumçka po varet nga procedurat tenderuese që po na vonohen, por megjithkëtë, mendojmë se nuk do të ketë probleme të thekuara

z.Zinaida Elmazi- Unë e përmenda atë kamerën dhe e di se ato janë shpenzime shtesë për transmetimin e Kuvendit në TV, por më duket pak e palogjikshme që TV-ja të pranon punëtorë dhe për këtë të kërkon donacion nka Komuna, si kusht për të pranuar punëtorë? Pra, çdo TV ka punëtorë e vetë dhe ekipet për dalje në terren të cilat paisen edhe me kamera. Dhe, nëse ne e kemi dhënë atë kamerë, dëshiroj që ai TV të bënë transmetimet tona, ndoshta jo drejtpërdrejtë, por përmes ndonjë emisioni për Kuvendin dhe aktivitetin e Komunës. Unë ende nuk kam parë diçka për komunën tonë, pos për Shën Gjergjin dhe mos po bëhen promovime të subjekteve politike sipas opsioneve politike që u përkasin ata persona?!

z.Laurat Krasniqi- Pyetja që parashtrova nuk ishte pa lidhje, por është tejet serioze. Juve, ndoshta, u është keqpërdorur nënshkrimi për përfitime materiale të disa individëve të cilët aktivitetin më të madh sportin të Komunës e kanë keqpërdorur, duke marr 450 litër vaj, të jemi normal me karburantin, 1 mijë euro për tupana?! Pra, kjo është skandal, është kriminal?! Problemi qëndron në atë se këta persona janë zyrtarë dhe kjo paraqet skenë kriminele e cila funksionon në kuadër të Drejtoratit të Kulturës, Rinisë e Sportit, ku zyrtari për këtë, në mënyrë konstante, keqpërdor mjetet e pse duhet të pyetet?! Këta të njejtit, janë ata që kanë bërë keqpërdorime të mjeteve edhe me rastin e vendosjes së lapidarit të Komandatit legjendar-Adem Jashari në Dragash. Dhe, të jeni të sigurt, se asnjërit nga aktivistët nuk i kanë paguar, madje asnjë kafe?! Pra, nevojitet transparencë dhe individëve këtu (sipas kësaj letëre-dokument) u është keqpërdorur nënshkrimi?! Ju lutem, ju jeni personi i parë në Dragash dhe këta njerëz janë zyrtarë të Komunës dhe nuk kanë të drejtën ligjore të janë OJQ?! Ata këto veprime po i bëjnë qëllimisht dhe, shumica e tyre, kanë bërë pasuri maramendëse, të jeni të sigurt në këtë?! Për këtë, menjëherë, duhet të shkohet në Prokurori e Gjykatë e këtë duhet t'a bëjmë të gjithë ne-bashkarisht. Këta, të njejtit persona, vijë dhe e kërcnojnë familjen time e unë jam i zgjedhuri i popullit dhe nuk e kam ndërmend të ndalem. Kjo është vetëm fillimi dhe dëshiroj t'u them se grupet kriminele ,të cilat janë nga pushteti i kaluar e që shumica ka qenë prezente edhe përmes qëndrimit në Budvë, si organizime të tilla duhet të ndërpriten?!

z.Vehbi Nazifi- Më vjen keq për këtë fakte që ceku kolegu, të cilat i kam parë edhe nëpër media e që nuk më kanë pëlqyer. Unë e kuptoj paraqitjen e tij mediale dhe e kisha lutur që për këtë terminologji, të importuar nga qendra. të mos t'a përdorni këtu te ne si- "kriminela, terrorista, etj" pasi se nuk është e ndershme nga ana juaj, sepse për t'u thënë diçka e tillë duhet të keni fakte. Unë e kam gjurmuar këtë deklaram tuajin e që e keni paraqitur edhe në internet dhe kam ardhur në përfundim se Komuna nuk ka pasur asgjë me këtë organizim dhe nuk kanë qenë të kyçura fare mjetete Komunës. Këtë aktivitet e ka organizuar një organizatë Sudeze ChWB e cila e ka përkrahur aktivitetin reth trashigimisë kulturore nëpër rajone të ndryshme dhe e kemi pasur fatin se ka vepruar edhe Komunën tonë. Donacioni është realizuar përmes OJQ-së dhe dijmë se ai aktivitet ka zgjatur gadi gjatë tërë ditës dhe mendoj se, njerzit që kanë punuar ditën e diel, është dashur t'u kompenzohet puna, pasi se, pa para, nuk punon askush. Personat të cilt janë në Listë mund të deklarohen se a kanë marr apo jo para?! Pa dyshim se, puna që punohet jasht orarit të punës, duhet të kompenzohet ,

madje vaji i hargjuar në shumë prej 450 litrave mendoj se është i vogël, pasi se mundësit janë lyer 4-5 herë në ditë e kanë qenë madje mbi 1 mijë njerëz. Dhe, nëse ka keqpërdorime, ekzistojnë prokuroritë e gjyqet e mua më ka interesuar se a ka qenë në pyetje paraja e Komunës, kurse ajo se si është fituar tenderi është çështje tjetër, por do t'u kisha lutur për vemendje në përdorimin e fjalorit, edhe pse e di se jeni të orjentuar kështu për hirë të opinionit, por jo me zhurmë për të cilësuar dikend me tarmat kriminelat etj.?!

z.Granit Rifaj- Mua më vjen mirë këto që po i prezentoni për keqpërdorime e për këtë ekzistojnë gjyqet dhe prokuroritë. Këtë po e theksoj në aspektin kolegjial dhe atë që po e theksoni se janë keqpërdorur mjete reth vendosjes së lapidarit të Komandatit legjendar Adem Jashari, s'di pse po theksoni diçka të tillë, pasi se kryetari personalisht se nuk ka pasur kurrfar mundësi për keqpërdorime, pasi se ai ka qenë donacion dhe disa gjëra nuk guxonin t'i përzieni, por t'i specifikoni mirë?! Nëse mendoni e keni dëshmi për keqpërdorime, silleni materialin me fakte dhe unë i pari do t'u bashkangjitem për fletparaqitje në Prokurori. Por, nuk është e ndershme nga ju që të shfrytëzohet personaliteti i Adem Jasharit për qëllime politike?!

z.Rexhep Kamberi- Në emër të GIG-ut angazhohem për transparencë të Kuvendit dhe objektivitet në raportime dhe them se e përkrahi propozimin se, nëse dikujt i është dhënë donacioni, ai ka edhe obligime për ato mjete, në radhë të parë obligim moral për të përcjellur punën tonë në mënyrë transparente e objektive. Në këtë mënyrë, ne nuk do të jemi pre e dyshimeve dhe hamendjeve, për të mos qenë ai tha kështu e tjetri ashtu e burimet anonime etj.?! Unë me këtë rast do t'a përhëndes redaktorin e "Gora-Presit" i cili, rregullisht, raporton për punën e Kuvendit dhe Komunës, në mënyrë objektive dhe nuk e di se a ka përfutur ai donacione dhe duhet pasur parasysh përkrahjet për ata që e përcjellin punën dhe aktivitetin tonë në mënyrë objektive e për të mos ardhur në shprehje spekulimet e ndryshme dhe është e vërtetë se dyshimet duhet paraqitur e ndriçuar përmes gjakatave e prokurorive, që mendoj se propozimet për këtë janë në rregull dhe me vend.

z.Laurat Krasniqi- Për kolegun e PDK-së Vehbi N. dua t'a kujtoj se keqpërdorimi i nënshkrimit është vepër kriminale dhe nuk është kjo "fjalë rruge", por në pyetje është institucioni dhe vula e nënshkrimit dhe s'di se a po e kuptoni këtë? Ne, si Lvetëvendosje, kosiderojmë se garat e pahlivanëve janë aktiviteti më madh sportiv dhe, sipas jush, këtyre që keqpërdorën, duhet dhënë shpërblime?! Shumica e atyre që kanë qenë në Listë, më kanë shkruar, se nuk i kanë marr ato para fare! Personi i caktuar i ka marr shënimet e kryesuesit të atëheshëm të Kuvendit dhe të qytetarëve tjerë dhe ka vepruar në emër të tyre e kjo paraqet veprë penale! Ju tani mua duhet të më dilni në mbrojtje, sepse unë këtu jam edhe për të mirën tuaj, por që do t'a kuptoni pas 4 viteve?! Kjo është çështje serioze e këtu është shukatur me vite? Kjo shukatje na ka sjell në situatë që ne patjetër të reagojmë. Lidhur me lapidarin e Adem Jasharit, nuk e thash se në pyetje është lapidari, por organizimi i ceremonisë, që është dallim. Unë për këtë jam i informuar detalisht dhe kam dëshmi se, ky grup, ashtu ka vepruar dhe nuk mund që një medalje të kushton 1 mijë euro, sepse ato nuk janë të arit, por të nga 5-10 euro, kurse

fatura është në rregull?! Jam i mendimit që dëshmitë t'i paraqiten Prokurorisë, Policisë dhe të tjerave intucioneve, sepse gjendja është shumë e keqe dhe çështen duhet kuptuar shumë seriozisht.

Kryesuesi- Sot ka qenë ditë e tolerancës dhe duhet t'a dini se nuk do të ketë të drejta të replikave, siç dëshironi, pasi se ekziston Rregullorja jonë e Punës.

z.Vehbi Nazifi- Ju përgëzoj për këtë, por nuk e kam të qartë se çka ka të bëjë Kuvendi me këto të ashtuqujtura - "keqpërdorime", nëse mua psh. më qenka keqpërdorur nënshkrimi dhe nuk ka nevojë që ju të ma zgjidhni problemin, por duhet t'a bëjë vetë dhe për këtë theksova se nuk ka nevojë për gjuhë të ashpër kur është fjala e asaj shoqate, kurse organizimi ka qenë perfekt dhe urdhëroni ju silleni një mundës ndërkombëtar në komuin tonë dhe do t'a shifni se sa kushton, sepse nuk është lehtë të organizohen gara të tilla. Nuk është në rregull që gjërat të gjeneralizohen me një organizim të cilin nuk po e mbroj unë, se aty jemi të gjithë bashkarisht, por desha të shprehi mospajtime me fjalorin që u përdor, sepse duhet të jemi Kuvend pa ofendime dhe se e dijmë se kjo që theksove më parë është zhargon i cili po tentohet të bëhet-hit?!

z.Granit Rifaj- Edhe në fillim theksova se për këtë iniciativë që e keni ndërmarr unë ju kisha përgëzuar. Por, edhe kryetari tha se ,lidhur me këto çështje, nuk do të kursen askend e mos të keqpërdoret në emër të mbrojtjes së tij tij figura e Adem Jasharit për qëllime politike, sepse kjo nuk ka kuptim e lidhje. Nëse lidhur me organizimin e Ditës së Çlirimit ka pasur keqpërdorime, lirisht mund të paraqiteni në Prokurori dhe Adem jashatin line rahat-aty ku është!

z.Zaim Hajredini- Mendoj se po bëhet shumë zhurmë për asgjë dhe rolin tonë duhet t'a kuptojmë seriozisht dhe të debatojmë për atë çka është në rregull dhe legjitime për ne. Edhe unë i kam parë ato gjëra që janë shpërndar përmes facebook, por s'do të thotë që, në Kuvend, të vijmë me ato gjëra që i shofim në facebook e ato gjëra t'i debatojmë?! Në dokument qartë thuhet se OJQ "Natyra" e ka bërë organizimin dhe organizime të tilla në Dragash janë bërë, ndoshta mbi 50-të dhe a ka pasur keqpërdorime? Keni OJQ të cilat nuk veprojnë, jo me 5 mijë euro por edhe me 50 mijë euro dhe manevrojnë e nuk kanë ndoshta asnjë aktivitet, por që ne nuk jemi të ngarkuar që t'i monitorojmë, sepse për këtë ekziston diokush tjetër? Se a ka të drejtën që një shërbyes civil të jetë koordinator i një OJQ-je, për këtë ekziston ministria kompetente e cila ia jep lejen apo ia refuzon atë. Ministria më 2017 e ka bërë auditimin e OJQ-ve nga të cilat ka kërkuar kritere të caktuara për të qenë OJQ?! Ajo se a kanë paguar 50 apo 500 euro ai është projekt i një OJQ-je e kjo nuk i përket fare komunës. Nuk ka nevoj të përdoren ata fjalor të ndryshëm për të hapur gjithfar debatesh, sepse kjo i takon vetëm asaj OJQ-së. Nëse është në pyetje buxheti i Komunës që i është ndaj ndonjë OJQ-je, atëherë, plotësisht, do të pajtohesh dhe, nëse aktiviteti qenka realizuar në komunë, çështja ju përket vetë atyre punëtorëve të asaj organizate dhe më thuaj se çka ka kjo të bënë me Komunën? Nuk dëshiroj të mbroj askend, por dëshiroj të theksoj se kemi mjaft punë dhe nuk duhet të merremi me atë që ne nuk e kemi në kompetencat tona. Nëse dëshironë transparencë të të Kuvendit, unë jam për këtë dhe do të jam gjithnjë ai i cili këtë e kam kërkuar se çka është bërë me investimet kapitale

dhe realizimin e buxhetit e këto janë çështje që na takojnë dhe duhet të punojmë e kjo, që u theksua më herët, ishte vetëm humbje kohe?!

z.Sefidin Mejzini- Nuk dola në foltore për të shitur mend, pasi se, ndonjëherë, nuk kemi as për vehte. Këtë që e theksoi kolegu nuk është për t'u nënçmuar e anashkaluar, por ky paraqet një leksion për kryetarin, pasi se aty i qëndron emri?! Dëshiroj që të jemi sa më të qetë dhe nuk duhet të nervozohemi dhe ky ishte leksion e këtë po theksoj në mënyrë kolegjale. Kryetari tani është këtu, pavarësisht se si ka ardhur në atë pozitë, ka ardhur. Sipas debateve e patë se sa gabime janë bërë dhe ky të jetë leksion për të gjithë ne. Prandaj, ju ftoj të gjithëve që t'i lëmë anash bisedat e kafeneve se nuk po kemi asgjë për rininë e në aspektin politikë unë dëshiroj që pushteti të bënë sa më shumë gabime, sepse ju kam rival politikë, për të fituar nga gabimet tuaja zgjedhjet e ardhëshme?! Por, gjithëse, në radhë të para i kemi qytetarët dhe dëshiroj që ky mandat të kalon siç është më së miri dhe apeloj që mos të merremi shumë me gjëra personale, pasi se njihemi mes vedi dhe duhet të kursehemi nga fjalët e rrlnda. Këtu e kemi nënshkrimin e kryetarit e ajo që po dëshiron Vehbi N. se nuk paska marr para, kjo i nganë asaj se "nëse je i marr, nuk din të vjedhësh"?!

z.Selman Osmani- E falënderoj kryetarin që na njoftoi me informacionet lidhur me zgjedhjen e nënkryetarit të komunës nga komuniteti joshumicë dhe e kisha lutur që, kur të merr informacione nga MAPL-ja, që këshutu, në mënyrë transparente, të na njofton se a kemi gabuar e që mos të shkelen ligjet në të ardhmen. Nëse ajo pozitë i takon komunitetit jo shumicë, duhet të respektohet Ligji e nuk duhet mbivotimi apo zhurma, sepse seanca kishte karakter solemn e të merremi, në të ardhmen, më shumë, me të drejtat tona ligjore. Nëse është dashur të jetë nënkryetri komuniteteve nga komuniteti Goran e jo nga ai Boshnjak, ashtu është dashur të jetë dhe do t'a falënderoja, paraprakisht, kryetarin që të na njofton me kohë lidhur me këtë çështje.

z.Zinaida Elmazi- Unë këtu nuk jam në mandatin e parë dhe sa i përket zgjedhjes së nënkryetarit për komunitete, kjo qëndron mirë në LV Lokale dhe duhet të zgjedhet kandidati i propozuar nga kryetari, duke fituar shumicën e votave të delegatëve të jo shumicës, që mendoj se nuk ka qenë problem te ne dhe për këtë nuk duhet të diksutojmë fare. Kjo, si duket, është inicuar nga dikush në emër të UA, që nuk është me rëndësi. Psh. Unë mund të jam Rome, Gorane e këtë nuk mund të ma mohon askush e, njëherësh, mund të jam Boshnjake në subjektin politikë e ky është përcaktim i im dhe akush s'mund të thotë se nuk jam Gorane e, nëse i takoj partisë boshnjake, është diçka tjetër. Ndoshta, Sherif Aga është Boshnjak e ndoshta Goran e kjo është e drejta e tij. Ai është i zgjedhur legjitim dhe e kanë zgjedh delegatët nga radhët e boshnjakëve dhe goranëve, që pra jo shumica e ka zgjedhur, duke fituar votat 5:1 dhe s'ka se çka të debatohet lidhur me këtë!

z.Selman Osmani- E nderuar kolege, unë askujt nuk po ia mohoj se kush si deklarohet-Goran apo Boshnjak, Shqiptar, Rom, Serb, Kroat etj. E kjo shtë e drejtë personale. Unë jam këtu të përfaqësoj komunitetin tim dhe, nëse ajo pozitë i takon komunitetit Goran, unë jam përfaqësues i atij komuniteti-Goran dhe dëshiroj që ajo pozitëtë ma takon neve. Kuvendi është organi më i larë dhe ne nuk duhet

të shkelim Ligjin dhe po e përmendi një shembull në Prizren, ku komunitetit jo shumicë-Turk, nuk ka nënkryetar e Boshnjakët e kanë gjithmonë e për këtë interesohu pak? Këtë po e theksoj se me regjistrimin e Popullsisë, te ne jam më shumë të deklaruar-Goranë dhe prap e lus kryetarin që, kur të merr mendimin e MAPL-së të na njofton këtu në mënyrë transparente, dhe, nëse kemi gabuar, atë Vendim t'a rishqyrtojmë e vendosim, siç duhet.

z.Zinaida Elmazi- Ne këtu punojmë sipas Ligjit dhe ashtu e kemi zgjedhur nënkryetarin për komunitete. E dyta, mendoj se nuk duhet të debatojmë reth kësaj dhe do të presim Vendimin e MAPL-së e mos të merremi me Prizrenin e të tjerët, pasi se në Ligj theksohet zgjedhja e nënkryetarit të komuniteteve – jo shumicë.

Kryetari- Mendoj se kjo pikë e ka qëllimin që delegatët të parashtrojnë pyetje e kryetari të përgjigjet e që, ndoshta, nga disa delegatë është kuptuar gabimisht. E respektoj entuziazmin e shumicës nga ju dhe pika e rendit të ditës është “eventuale” e jo të kalohet në pikëtë posaçme të rendit të fitës dhe ju kisha lutur që në këtë frymë të diskutohet e jo të hapen debate të panevojshme e jasht rendit të ditës. Nëse mendoni se pyetje e juaj kërkon debat, atëherë duhet të propozohet pikë e posaçme-nëse vendosni e dikush theksoi se takimet tona monitorohet e kjo të merret parasysh.

Kryesuesi- Nëse nuk kemi diskutime të tjera, me këtë, përfundojmë seancën e sotme të Kuvendit. Ju felemderit dhe mirë ui pafshim në seancën e radhës.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

K r y e s u e s i :

Betim Merdiu